



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Qershor 2022

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Qershor 2022

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në këtë edicion të këtij buletini pasqyrohen
aktivitetet për muajin qershor të vitit 2022)**

**Shqyrtohet kërkesa buxhetore për vitin 2023
dhe vlerësimet e hershme për periudhën
2024-2025**

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës mbajti takimin e radhës, në të cilin shqyrtoi Kërkesën buxhetore për vitin 2023 dhe vlerësimet e hershme për vitin 2024-2025 për të gjitha programet buxhetore të KPK-së dhe kategoritë ekonomike të buxhetit.



Pas shqyrtimit të kërkesave për staf shtesë, mjete shtesë në paga dhe mëditje dhe në mallra dhe shërbime, anëtarët e Komisionit aprovuan Kërkesën buxhetore dhe të njëjtën e rekomanduan për aprovim në Këshillin Prokurorial.

Dekretohen shtatë prokurorë të rinj

Pas propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka dekretuar sot shtatë prokurorë të rinj me mandat fillestar për tri vite.



Prokurorët e rinj janë betuar se “do t'i qëndrojnë besnik Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve në fuqi dhe do të respektojnë rregullat e etikës profesionale”. Prokurorët e rinj do të sistemohen në prokuroritë Themelore në Prishtinë, Pejë, Gjakovë dhe Ferizaj.

Mbahet Konferenca e Forumeve Rajonale të Gjyqtareve dhe Prokuroreve

Në konferencën dyditore të organizuar në Tiranë, me iniciativë të Forimit të Gjyqtareve dhe Prokuroreve të Kosovës dhe në bashkëpunim me UNDP-në, morën pjesë 43 gjyqtare dhe prokurore nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.



Më këtë rast, gjyqtaret dhe prokuroret nga të tre vendet vlerësuan lartë rëndësinë e një organizimi të tillë që do të shërbejë si nismë e një bashkëpunimi afatgjatë për të fuqizuar pozitën e grave në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për t'u angazhuar në ngritjen e efikasitetit të drejtësisë për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

Prezantohet analiza për reformën e administratës së sistemit prokurorial

EUKOJUST organizoi punëtori për prezantimin e analizës për identifikimin e mangësive në reformën e administratës, që përfshin hartimin e akteve normative, zbatimin e konceptit të reformës dhe standardizimin e administratës së sistemit prokurorial.



Gjatë diskutimeve interaktive, u theksua se ka rritje të ndjeshme të pritjeve për planifikimin e rishpërndarjes së burimeve njerëzore dhe sistemin e burimeve të reja, siç është strukturimi i Sekretariatit të KPK-së, burimeve njerëzore në ZKPSH dhe prokuroritë e të gjitha niveleve, rritja e përgjegjshmërisë, përmirësimi i burimeve menaxheriale, digjitalizimi dhe harmonizimi ndërsektorial.

Miratohet shpallja e konkursit për njëzet e dy prokurorë të rinj të Shtetit

KPK mbajti takimin e 216-të, në të cilin fillimisht miratoi Raportin e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimin Ekonomik për periudhën janar-mars 2022. Pas miratimit të Rregullores për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, u mor vendimi për shpalljen e konkursit për rekrutimin e njëzet e dy (22) prokurorëve të rinj të Shtetit dhe u themeluan Komisionin për Rekrutim dhe Komisioni për Rishqyrtim, duke caktuar anëtarët përkatës të tyre.



u miratuan edhe: Udhëzuesi për zbatimin e Rregullores për transferimin dhe avancimin e Prokurorëve të Shtetit dhe kërkesa buxhetore për vitin 2023 dhe vlerësimet e hershme 2024 dhe 2025, Plotësim-ndryshimi i Vendimit të KPK-së për ekspertët gjyqësorë që angazhohen nga ana e Prokurorit të Shtetit, që do të zbatohet në përputhje me Rregulloren e KGJK-së për kompensimin e ekspertëve gjyqësorë.

Diskutohet për përmirësimin e trajtimit të rasteve të dhunës gjinore

Në kuadër të zbatimit të luftës kundër dhunës me bazë gjinore, Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës priti në takim përfaqësueset e programit kundër dhunës me bazë gjinore të Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK), ku u vlerësua kontributi i Rrjetit të Grave të Kosovës për sensibilizimin e opinionit publik dhe mekanizmeve të ndryshëm kundër dhunës gjinore, duke theksuar se do të ketë zbatim të rekomandimeve të dala nga raporti i kësaj organizate për sistemin prokurorial.



Përfaqësueset e RrGK-së u njoftuan edhe për definimin e të dhënave të palëve gjatë procesit të regjistrimit të tyre në SMIL, me theks të veçantë të viktimave të dhunës gjinore, të cilat sigurohen nga Regjistri Civil.

Deklaratë e Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës shprehu shqetësimin e tij për kalimin në lexim të dytë të Ligjit për KPK-në në Kuvendin e Kosovës. Këshilli Prokurorial, që nga fillimi i procesit të hartimit të Projektligjit të KPK-së, ashtu siç parashihet me Strategjinë për sundimin e ligjit, ka dhënë kontributin e tij nëpër grupet punuese të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Kuvendin e Kosovës, ku ka dalë me propozime konkrete, të cilat nuk janë marrë parasysh asnjëherë nga Ministria e Drejtësisë, respektivisht, nga komisioni përkatës i Kuvendit të Kosovës.



KPK-ja konsideron se votimi i këtij ligji, në këtë mënyrë, cenon rëndë pavarësinë e këtij organi kushtetuese. Për më tepër, përmbajtja e këtij ligji do të pamundësojë funksionalizimin e sistemit prokurorial dhe do ta bëjë atë lehtësisht të ndikuar nga politika. Meqenëse me këtë Ligj cenohet mandati kushtetues i anëtarëve të Këshillit, Këshilli njofton se përveçse do t'i ndjekë të gjitha rrugët ligjore për të kontestuar përmbajtjen e këtij ligji, gjithashtu, asnjë anëtar i Këshillit nuk do t'i nënshtrohet kërkesave kundërkushtetuese dhe antiligjore që janë edhe kundër standardeve ndërkombëtare, por edhe kundër dy rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Venecias.

Angazhimi i shtuar dhe planifikimi i mirë, në fokus të takimit të Sekretariatit të KPK-së me administratorët e prokurorive të vendit

Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së, me bashkëpunëtorë, mbajti një takim me administratorë të të gjitha prokurorive të vendit.



Me këtë rast, u kërku nga administratorët një angazhim më të shtuar dhe planifikim të mirë të punëve për realizimin e objektivave të punës, përfshirë menaxhimin e buxhetit dhe shpenzimet financiare, si dhe hartimin e shkresave dhe raporteve të sakta që përmbajnë të dhëna për mbështetjen e tyre me staf shtesë, pajisje të nevojshme dhe për ofrimin e shërbimeve të duhura.

Reagim i përbashkët i KGJK-së dhe KPK-së

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) kanë reaguar lidhur me deklaratën e deputetit të Lëvizjes Vetëvendosje, z. Dimal Basha, i cili ka komentuar rreth çështjes së vetingut për gjyqtarë dhe prokurorë, përmes shkrimit në portalin Insaideri.org, të datës 24.06.2022, me titullin: "Deputeti i Vetëvendosjes për prokurorët e gjykatësit kosovarë: Nuk dallojnë me ata të Millosheviqit".



KGJK-ja dhe KPK-ja shprehën pakënaqësi dhe konsideruan se deklarata e deputetit Basha është e papranueshme dhe ka për qëllim cenimin e integritetit, pavarësisë dhe dëmtimin e imazhit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në përgjithësi. Një deputet i Kuvendit

të Republikës së Kosovës duhet të jetë shembull i respektimit të organeve zbatuese të ligjit dhe të përmbahet nga deklaratimet e tilla që janë kundërshtim me rendin dhe parimet kushtetuese e ligjore.

Deklaratat dhe reagimet e tilla nuk i kontribuojnë bashkëpunimit të institucioneve me sistemin gjyqësor dhe prokurorial, prandaj KGJK-ja dhe KPK-ja u bëjnë thirrje deputetëve që të kontribuojnë duke reflektuar dhe duke respektuar pavarësinë e të dy sistemeve.

Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial i sigurojnë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës se do të vazhdojnë të angazhohen për një sistem gjyqësor dhe prokurorial të pavarur, transparent dhe të paanshëm. Prandaj, i bëjmë thirrje deputetit Basha që të evitojë këtë lloj të deklaratave, që, në këtë rast, sipas vlerësimit të KGJK-së dhe KPK-së, është fyese, denigruese dhe përpjekje e pasuksesshme për njollasje dhe etiketim të vlerave të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në përgjithësi.

Theksojmë se sistemi gjyqësor dhe prokurorial i Republikës së Kosovës përbëhet nga institucione profesionale, të themeluara me Kushtetutë dhe ligje, të cilat janë të përkushtuara në përmbushjen e misionit, vizionit dhe objektivave të tyre dhe janë të pandikuara nga çfarëdo pretendimi.

Deklaratë e KPK-së

KPK-ja deklaroi se ashtu siç ka njoftuar paraprakisht se do të ndjekë të gjitha rrugët ligjore, ka bërë kërkesë në Institucionin e Avokatit të Popullit për referimin e Ligjit të ndryshuar për KPK-në në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.



Këshilli Prokurorial deklaroi gjithashtu se komentet e tij ndërlidhen me evidentimet konkrete të shkeljeve kushtetuese dhe ligjore që janë bërë me anë të këtij ligji, të miratuar më 23 qershor 2022, në Kuvendin e Kosovës.

KPK-ja ka thënë se dëshmon që mbetet i përkushtuar që kontestimin e këtij ligji ta bëjë vetëm nëpërmjet rrugëve kushtetuese dhe ligjore dhe do të vazhdojë të angazhohet për një sistem prokurorial të pavarur, të paanshëm, transparent dhe çdo herë në zbatim të ligjit.

Në frymën e kësaj, Këshilli Prokurorial i Kosovës, thekson se çfarëdo keqinterpretimi i ngritur në

opinionin publik lidhur me moszbatimin e akteve ligjore është i paqëndrueshëm.

Kërkohet përkushtim i vazhdueshëm në trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike

Në kuadër të angazhimeve për monitorimin e zbatimit të Strategjisë së sistemit prokurorial (2022-2024) dhe Planit të veprimit, Komisioni Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomikem ka vizituar Prokurorinë Themelore të Gjilanit.



Me këtë rast është diskutuar lidhur me lëndët e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, trajtimin e tyre dhe sfidat e ndryshme që dalin në rrugën që ka përpara kjo prokurori, kurse, gjatë takimit, ky Komision, përkundrejt rezultateve të arritura në këtë prokurori, të cilat janë mjaft të kënaqshme, kërkoi një përkushtim të vazhdueshëm të saj në trajtimin e këtyre lëndëve edhe pse numri i prokurorëve nuk është i mjaftueshëm.

Mbahet takim për prezantimin e Rregullores për Menaxhimin e Lëndëve përmes Sistemit Elektronik

KPK-ja, në bashkëpunim me projektin britanik, EUKOJUST, mbajti një takim dyditor për prezantimin e Rregullores për Menaxhimin e Lëndëve përmes Sistemit Elektronik (SMIL).



Gjatë takimit, u prezantua mënyra e menaxhimit të procesit në prokurori përmes SMIL-it në përputhje me Rregulloren, e cila është miratuar nga Këshilli në muajin dhjetor 2021 dhe e njëjta do të fillojë të zbatohet nga 1 korriku 2022.

Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

SKPK-ja ka dhënë komentet e veta për draftin e Memorandumit të Bashkëpunimit mes Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Akademisë së Drejtësisë dhe Memorandumit të Bashkëpunimit mes Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Byrosë Kosovare të Sigurisë.

Gjithashtu ka hartuar një përgjigje ndaj Raportit të Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD) për monitorimin e Këshillit Prokurorial për vitin 2021.

Kurse, aspektin e trajnimeve profesionale, është marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga Ambasada Amerikane për qasjen në dokumente publike dhe në punëtorinë për diskutimin e draftit të Ligjit për Sistemin Qendror të Evidencës Penale dhe punëtorinë e organizuar nga EUKOJUST, në të cilën është prezantuar analiza për reformën e administratës së sistemit prokurorial.

Ndërkohë ka përgatitur Kërkesën Buxhetore për vitin 2023 dhe vlerësimet e hershme për 2024-2025 dhe ka Raportin financiar të KPK-së për vitin 2021.

SKPK-ja mbajti takim me përfaqësuesit USAID-it, me të cilët diskutoi mundësinë e prezantimit të projekteve për financim nga donatorët dhe ka vazhduar procesi i ritrajnimit për përdorimin e SMIL-it për stafin administrativ dhe prokurorët në të gjitha prokuroritë e vendit.

Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

NJSHPP-ja gjatë muajit qershor ka qenë e përqendruar në: hartimin e raportit analitik për ngarkesën e prokurorisë me lëndë për tremujorin e parë 2022 krahasuar me tremujorin e parë 2021, sipas Planit të Punës së KPK për vitin 2022, hartimin e raporteve analitike të përcaktuara me Planin e Punës së KPK-së për vitin 2022, hartimin e raportit për numrin e prokurorëve që kanë trajtuar lëndë në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore për vitet 2020 dhe 2021 dhe shpërndarjen e tyre nëpër prokurori themelore, sipas kërkesës për qasje në dokumente publike, raporti informues për të dhënat statistikore të nxjerra nga SMIL-i krahasuar me shënimet me raportet fizike që janë pranuar nga prokuroritë, mbështetjen e procesit të transferimit të

prokurorëve, si dhe angazhime tjera në përmbushje të obligimeve ligjore në kuadër të ZMAVP-së.

NJSHPP-ja ka grumbulluar edhe të dhëna statistikore dhe kaq përpiluar pasqyra për ngarkesën dhe efikasitetin e prokurorisë në zgjidhjen e lëndëve nga regjistrat: PP, PPM, PPN, PPP dhe NJN; të dhëna statistikore për gjendjen e rasteve në prokurori sipas departamenteve dhe llojeve të regjistrave: PP, PPM, PPN, PPP dhe NJN dhe gjendjen e rasteve në prokurori për rastet karakteristike nga Mekanizmi përcjellës për harmonizimin e shënimeve statistikore sipas grupeve të veprave penale; ka përpunuar të dhëna për raportet statistikore për TM-II-të dhe Raportin gjashtëmuajor, 2021 për rastet penale, si dhe është monitoruar moduli për raporte statistikore të SMIL-it.